

STATUT & AKT THEMELIMI
. I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
autobus.al sh.p.k.

KREU I
EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1
Emertimi

Bazuar ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, ne ligjin nr. 7512 dt. 10.08.1991 "*Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe privatizimit*", ne nenin 11 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008, me vullnetin e tyre te lire, sot me **dt. 25.10.2019**, ortaket:

1. **Z. Ferjolt Ozuni**, i biri i Ferit, lindur me 24.08.1986 ne Prrenjash, Shqiperi, banues ne Tirane, Rruga Nacionale Dajtit, P. Hoxholli, K.7, Ap. 53, me numer personal identifikimi I60824050J,
2. **Zj. Elda Ozuni**, e bija e Bektash, lindur me 01.07.1987 ne Cerme Proshke, Shqiperi, Shqiperi, banues ne Tirane, Rruga Nacionale Dajtit, P. Hoxholli, K.7, Ap. 53, me numer personal identifikimi I75701035U

krijojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar autobus.al.

Neni 2
Aktiviteti i Shoqerise

- 2.1. Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (shpk), e krijuar ne baze te legjislacionit Shqiptar, sic mund te ndryshohet here pas here.
- 2.2. Shoqeria **autobus.al** sh.p.k do te kryeje kryesisht, por pa u limituar, aktivitetin e meposhtem:
 - Shitje dhe rishitje bileta nderkombetare autobusi online (nepermjet sistemeve elektronike) dhe ne menyre tradicionale (ne zyre/agjenci/pika shitje);
 - Shitje dhe rishitje bileta interurbane/rrethqytetase/nderqytetase autobusi online (nepermjet sistemeve elektronike) dhe ne menyre tradicionale (ne zyre/agjenci/pika shitje);
 - Ofrim bileta nderkombetare autobusi te treteve per rishitje;
 - Ofrim bileta interurbane/rrethqytetase/nderqytetase autobusi te treteve per rishitje;
 - Rishites bileta nderkombetare autobusi me nisje ose jo nga Shqiperia;
 - Rishites bileta interurbane/rrethqytetase/nderqytetase autobusi;
 - Ofrimin e Sistemit te Biletimit Elektronik dhe te mirembajtjes / menaxhimit te linjave te transportit nderkombetar por dhe interurban/rrethqytetas/nderqytetas te udhetareve per operatorët e linjave respektive brenda dhe jashte Shqiperise;
 - Ofrim per rishitje nepermjet Sistemit te Biletimit Elektronik te Biletave Nderkombetare

por dhe atyre interurbane/rrethqytetase/nderqytetase tek te tretet brenda dhe jashte Shqiperise;

- Ofrimin e Sistemit te Biletimit Elektronik per menaxhimin e Biletave Elektronike nga operatorët e transportit nderkombetar te udhetareve;
- Ofrimin e Sistemit te Biletimit Elektronik per menaxhimin e Biletave Elektronike nga operatorët e transportit interurban/rrethqytetas/nderqytetas te udhetareve;
- Ofrim sherbim mirembajtje llogarie ne Sistemin online te Biletimit Elektronik;
- Shitje bileta nderkombetare autobusi nepermjet sistemit / sistemeve online/elektronike;
- Shitje dhe rishitje bileta interurbane/rrethqytetase/nderqytetase autobusi nepermjet sistemit / sistemeve online/elektronike
- Rishitje te Biletave Nderkombetare te Autobusit nepermjet sistemit / sistemeve online;
- Marrjen dhe dhenien e komisioneve per shitje dhe rishitje bileta autobusi online dhe offline;
- Agjenci komisionere;
- Mjete transporti udhetaresh (furgon, autobus) me qera nga dhe per te tretet brenda dhe jashte Shqiperise;
- Pjesemarrje ne shoqeri, ortakeri apo shoqeri te thjeshta (konsorcium dhe joint venture) nepermjet zoterimit te kuotave/aksioneve, pjeseve te fitimit si dhe kryerja e investimeve ne shoqeri Shqiptare dhe te huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqerive me asistencë ne veprimtarine e tyre;
- Realizimin e projekteve koncesionare dhe/ose partneritet publik-privat me institucione te pushtetit qendror dhe autoritetet vendore, ne fusha te ndryshme, per vete apo per persona te trete, perfshire ketu edhe asistencen dhe konsulencen teknike, ligjore, financiare, fiskale kundrejt shoqerive tregtare dhe/ose institucioneve publike ne kryerjen e procedurave koncesionare dhe/ose partneriteteve publike-private ne cdo sektor apo edhe kundrejt paleve te tjera financiare, tregtare apo te tjera;
- Shitje dhe ofrim sherbimesh dytesore si siguracione shendetesore dhe siguracione mjeteshe, rezervim hoteli brenda dhe jashte Shqiperise, bileta avioni, bileta trageti, makina me qera, organizim eventesh turistike;
- Sherbime konsulence per operatorët e transportit te udhetareve, per agjencite Turistike, agjencite e udhetimit, operatorët turistike, etj;
- Hapje, krijimi dhe menaxhim agjenci turistike, agjencie udhetimi dhe agjenci operatore turistike;
- Ndertim/krijim, formulim, kontraktim, shitje dhe rishitje te paketave turistike brenda dhe jashte Shqiperise;

Neni 3


Kohezgjatja e Shoqerise

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pa afat deri ne nje vendim te dyte qe do te mund te limitoje apo percaktoje kohezgjatje tjeter.

Neni 4

Selia e Shoqerise

4.1. Selia e shoqerise gjendet ne Rrugen "Arkitekt Kasemi", P. Hodo, K.1, Ap.4, KP. 1015,



Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

- 4.2. Gjithashtu, shoqeria do te kete faqe kryesore internet (website) www.autobus.al por mund te hape/krijojte edhe website te tjera te lidhura me te ose qe mund te operojne te pavarura pa pasur nevojten e deklarimit te tyre ne Statut apo Akt Themelimi. Ndersa per komunikimet elektronike do te perdure vetem adresa email bazuar ne website kryesore si sistemi@autobus.al; financa@autobus.al, por qe nuk limitohet vetem tek keto.

Neni 5

- 5.1. Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin. Shqiptar ne fuqi dhe me statutin e saj, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, online dhe ne menyre tradicionale (offline). Shoqeria mund te krijojte filial edhe ne vende ne perputhje me legjislacionin e vendit perkates.

Neni 6

Konfidencialiteti

- 6.1. Ortaket si dhe personat e tjere te pranuar/punesuar ne shoqeri, bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponojne nga bashkepunimi apo punesimi ne shoqeri sic mund te jene kontratat qe ajo do te lidh, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhme e saj, por pa u limituar vetem ne to.

KREU II KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 7


Kapitali Themeltar dhe Kuotat

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **autobus.al** sh.p.k eshte 10.000 (dhjetemije) leke. Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket e shoqerise. Shoqeria mund te shtojte ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 7.2. Kapitali themeltar perbehet nga kontributi i meposhtem: 10.000(dhjetemije) lek ose 100% te kapitalit themeltar.
- 7.3. Kapitali eshte i ndare ne 2 (dy) kuota, ku:
- 1 (nje kuote) me vlere 5.100(pesemijenjeqind) lek, apo 51% e kapitalit dhe aksioneve te Shoqerise, zoterohen nga ortaku z. Ferjolt Ozuni.
 - 1 (nje kuote) me vlere 4.900(katermijenenteqind) lek, apo 49% e kapitalit dhe aksioneve te Shoqerise, zoterohen nga ortaku zj. Elda Ozuni.
- 7.4. Pergjegjesia e Ortakeve per detyrimet e Shoqerise shtrihet deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

- 8.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:



- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashegimise;
 - d) dhurimit;
 - e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 8.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 8.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET DREJTUESE

Neni 9


Organi Vendimmarres

- 9.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 9.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 9.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "c" te kesaj pike;
 - f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
- 9.5. Pasuria e ortakeve, administratoreve, punonjesve dhe/ose agjenteve te Shoqerise eshte e perjashtuar nga cfaredo lloj detyrimi qe rendon mbi Shoqerine.


Neni 10

Administrimi

- 10.1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riprteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



- 10.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- 10.3. Personat e meposhtem caktohen si Administratore te shoqerise per 5 vitet e ardhshme, ose deri ne nje doreheqje, shkarkim apo vendim tjetër nga ana e Asamblese se Pergjithshme.


Te dhenat e identifikimit: (emrat, mbiemrat, identifikimi, adresat):	Specimenet e Nenshkrimtit
1. Nikoleta Ozuni <i>Lindur ne Korce, Shqiperi me 25.06.1962, me numer personal identifikimi G25625075U dhe adrese: Rr. Nacionale Dajtit, P. Hoxholli, K. 7, Ap. 53, Tirane, Shqiperi</i>	

- 10.4. Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij/saj.
- 10.5. Administratori do te ushtroje kompetencat e tij perkatese deri ne me te parin nga rastet e meposhtme:
- largimin e tij;
 - verifikimi i ngjarjeve te percaktuara ne Statutin dhe /ose Akt Themelimin e Shoqerise;
 - perfundimi i afatit 5 vjecar nga data e ketij akti, nese mandati nuk eshte rinovuar.
- 10.6. Administratori ka kompetenca te plota per te marre vendime per administrimin e zakonshem te Shoqerise, pervec kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit te zbatueshem. Administratori do te kete keto kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise sipasa parashikemeve te Ligjit.

Neni 11

Kompetencat e Administratoreve

- 11.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:
- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
 - b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
 - c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
 - d) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
 - e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - f) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
 - g) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
 - h) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- 11.2. Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.





- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 11.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.
- 11.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 12

Pergjegjesite e Administratorit

- 12.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.
- 12.2. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:
 - a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
 - b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
 - c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
 - d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
 - e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
- 12.3. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- 12.4. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
- 12.5. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e meposhtme:
 - a) u kthen ortakeve kontributet;
 - b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
 - c) u shperndan aktivet shoqerise;
 - d) c) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.



Neni 13

Punesimet ne Shoqeri

- 13.1. Per punonjesit qe do te punesohen, marredheniet juridike midis shoqerise dhe te punesuarve do te rregullohen me kontraten e punes ne perputhje me dispozitat ligjore dhe Kodin e Punes.
- 13.2. Punesimet ne shoqeri behen nga administratori/administratoret e Shoqerise por me pelqimin e Ansamblese se Pergjithshme te Shoqerise.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 14

Viti Financiar

- 14.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet



- 15.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 15.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 16

Prishja dhe likuidimi

- 16.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :
- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;
 - e) me vendim te gjykates;
- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.



- 16.2. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise pagueese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 16.3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.
- 16.4. Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 17

RiorganizmiiShoqerise Bashkimi-Ndarja

- 17.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vednimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

Neni 18

Baza Ligjore

- 18.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 18.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 19

Mosmarreveshjet

- 19.1. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.


Neni 20

Dispozitat e Fundit

- 20.1. Ky statut u hartua ne 3 (tre) kopje ne gjuhen Shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore. Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, do te bazohet ligji "Per Shoqerite Tregtare" dhe Kodi Civil i Republikes se Shqiperise qe eshte ne fuqi.

ORTAKET THEMELUES
TE Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
autobus.al

Ferjolt Ozuni



Elda Ozuni

